



Breaking News:

Tiranë/Finalizohet operacioni policor i koduar “Rental house”.

|| ◀ ▶

Lajmet

Operacionet

31/12/2025

Kurbin/Finalizohet Operacioni Policor I Koduar “Reagimi”

Kurbin/Finalizohet operacioni policor i koduar “Reagimi”.

Ndërhyrja e menjëhershme e shërbimeve të Policisë parandaloi ngjarje të mundshme kriminale.

Lëvizte i dehur dhe i armatosur me kallashnikov, kërcënonte qytetarët, thyente xhamat e automjeteve dhe të një lokali, falë ndërhyrjes profesionale të shërbimeve policore, u neutralizua dhe u vu në pranga 28-vjeçari.

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Kurbin, menjëherë pas marrjes së informacionit se një shtetas i armatosur lëvizte me armë zjarri automatike në dorë, kërcënonte qytetarë dhe dëmtonte prona në zonë, organizuan dhe finalizuan operacionin policor të koduar “Reagimi”.

Shërbimet e Policisë, në kuadër të këtij operacioni, kapën dhe vunë në pranga shtetasin A. Gj., 28 vjeç, banues në Laç.

Ky shtetas, në gjendje të dehur, lëvizte i armatosur, kërcënoi disa qytetarë, theu xhamat e tre automjeteve dhe të një lokali me qytën e kallashnikovit.

Në momentin e arrestimit, atij iu gjetën dhe iu sekuestruan një armë zjarri automatike dhe municion luftarak.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë për veprime të mëtejshme.

Kërko

Enter a word for search

Q

Komisariati Dixhital



Arkiva

Select Month

▾

Linqe

- > Arkiva
- > Akademia e Sigurisë
- > Ministria e Brendshme
- > Agjencia e Mbikëqyrjes Policore
- > Interpol
- > Europol
- > Misioni PAMECA V
- > SCPA
- > Projekti Trivalent

◀ Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Rrugore Tiranë, pranë fëmijëve në vigjilje të festës së ndërrimit të viteve.

Urimi i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Drejtues Madhor Ilir Proda, për Vitin e Ri 2026 ▶